



Republika e Kosovës
Qeveria - Vlada – Government

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine -Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

Ref. Nr. 01/59
26.07.2023

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), nenit 25, 50 dhe 52 të Ligjit nr. 06/L-033 për Produkte të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 21 / 05 Dhjetor 2018), si dhe nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 dhe Shtojcës 12 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, merr:

V E N D I M

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 4, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MINT) nr. 08/2022 për përcaktimin e kushteve për vendosjen e betonit të gatshëm në treg, me tekstin si në vijim:

1.1. Paragrafi 1 Nën-paragrafi 1.6, i nenit 3, shtyhet hyrja në fuqi nga data 1 Qershor 2023 deri me datën 1 Qershor 2025.

2. Deri në hyrjen në fuqi të paragrafit 1 të këtij vendimi, sistemi për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës do të vazhdojë të zbatohet deri në 31 Maj 2025, si në vijim:

	<i>Karakteristika(t)</i>
Sistemi AVCP 3 - Testimi nga trupi i emëruar	- Klasa e rezistencës në shtypje /klasa e betonit - Klasa e konsistencës ose vlera e synuar
Sistemi AVCP 4 - Deklarata e performancës së prodhuesit	Të gjitha karakteristikat tjera

Arsyetim

Ndryshimi i paragrafit 1, Nën-paragrafi 1.6, të nenit 3, me të cilin bëhet shtyrja e hyrjes në fuqi nga data 1 Qershor 2023 deri me datën 1 Qershor 2025, është se Departamenti i Industrisë/MINT deri më tani nuk ka pranuar asnjë kërkesë për marrjen e “Emërimit” nga ndonjë trup certifikuese (SK EN ISO 17065), gjë që ka rezultuar në mos zbatimin e nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MINT) NR. 08/2022 për Caktimin e Kushteve për Vendosjen e Betonit të Gatshëm në Treg. Gjithashtu në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit nuk ka pasur asnjë kërkesë për akreditimin nga trupat certifikuese, proces ky i cili është i detyrueshëm për “emërim” për vlerësimin e performancës së produkteve të ndërtimit ku bënë pjesë edhe betoni.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta Hajdari

Ministre

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit të Industrisë;*
- *Inspektoratit Qendror për Mbikëqyrjen e Tregut;*
- *Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit.*